REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E SHTIMES/OPŠTINA ŠTIMLJE
Nr i Prot.Br. Pro. 02/179
Nr i Faqeve/Br strana
Data/Datum 17.09.2026
SHTIME/ŠTIMLJE

European Youth Card
Karta Rinore Evropiane - Kosova

17/09/2026
02/1048

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

KOMUNËS SË SHTIMES

DHE

FONDACIONI BONEVET PRISHTINË

SHTIME, 2026

f. organizimin ose bashkëorganizimin e aktiviteteve informuese, edukative dhe promovuese për të rinjtë;
g. vendosjen e stendave informuese dhe shpërndarjen e materialeve gjatë eventeve dhe aktiviteteve publike;
h. shkëmbimin e informacionit, përvojave dhe praktikave të mira në fushën e zhvillimit rinor;
i. nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet strukturave komunale dhe BONEVET Prishtinë për zhvillimin e iniciativave të përbashkëta në fushën e rinisë.

Neni 3
Angazhimet e palëve

Palët pajtohen që gjatë zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në këtë memorandum të respektojnë dispozitat ligjore të aplikueshme dhe rregullat e brendshme të secilit institucion:

a. **Fondacioni BONEVET Prishtinë angazhohet të**:promovojë bashkëpunimin me Komunën e Shtimes përmes kanaleve të komunikimit dhe rrjeteve sociale, të përfshijë Komunën në aktivitete që lidhen me Kartën Rinore Evropiane dhe të mbështesë promovimin e iniciativave komunale rinore;
b. **Komuna e Shtimes angazhohet të:**mundësojë prezantimin dhe promovimin e Kartës Rinore Evropiane gjatë aktiviteteve komunale dhe të mbështesë shpërndarjen e materialeve promovuese tek të rinjtë;ndihmojë në sigurimin e lejes nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) për organizimin e prezantimeve informuese të Kartës Rinore Evropiane në shkollat publike të komunës;ndajë, përmes Zyrës për Zhvillim Ekonomik Lokal, kontaktet e bizneseve relevante të komunës me Fondacionin BONEVET Prishtinë, me qëllim zgjerimin e rrjetit të partnerëve të Kartës Rinore Evropiane;
c. palët pajtohen që gjatë implementimit të aktiviteteve të mos cenojnë veprimtarinë e palës tjetër.

Neni 4
Komunikimi dhe koordinimi

Për qëllime të zbatimit të këtij Memorandumi, secila palë cakton nga një person kontaktues përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve dhe komunikimin ndërmjet palëve:

a. personi kontaktues i caktuar nga Komuna e Shtimes është: Sanije Sadiku, Drejtore për Kulturë, Rini dhe Sport, tel: +383 44 835 074, e-mail: sanije.sadiki@rks-gov.net;
b. personi kontaktues i caktuar nga Fondacioni BONEVET Prishtinë është: Artina Bojku, tel: 049129846, e-mail: artinabojku@bonevet.org.

European Youth Card
Karta Rinore Evropiane - Kosova

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

i nënshkruar më datë 17/09/2026 ndërmjet:

1. **Komuna e Shtimes**, Shtime, Republika e Kosovës, me numër fiskal 600258976, e përfaqësuar nga **Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës së Shtimes**, nga njëra anë, dhe në anën tjetër,
2. **Fondacioni BONEVET Prishtinë**, implementues i Kartës Rinore Evropiane në Kosovë (EYCA Kosovo), Rr. "Hilë Mosi" nr. 11, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër fiskal 601810197, e përfaqësuar nga **Artina Bojku, Koordinatore e Projektit**.

Neni 1
Lënda dhe qëllimi

Fondacioni BONEVET Prishtinë, në cilësinë e implementuesit të Kartës Rinore Evropiane në Kosovë, dhe Komuna e Shtimes, përmes këtij Memorandumi të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit, pajtohen që të krijojnë partneritet me qëllim promovimin dhe implementimin e Kartës Rinore Evropiane në nivel lokal, duke kontribuar në rritjen e qasjes së të rinjve në mundësi zhvillimi, përfitime dhe aktivitete që mbështesin përfshirjen e tyre aktive në jetën shoqërore dhe komunitare.

Në këtë kuadër, bashkëpunimi synon gjithashtu rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve për përfitimet dhe mundësitë që ofron Karta Rinore Evropiane, si dhe fuqizimin e rolit të Komunës në mbështetjen e politikave dhe iniciativave rinore në nivel lokal.

Neni 2
Fushat e bashkëpunimit

Fushat e bashkëpunimit mes palëve në këtë memorandum do të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

a. pjesëmarrjen e përfaqësuesve të palëve në konferenca, forume, panele diskutimi dhe aktivitete të tjera publike;
b. facilitimin e bashkëpunimit me Drejtorinë e Arsimit dhe institucionet arsimore publike, me qëllim mundësimin e organizimit të prezantimeve informuese për të rinjtë lidhur me Kartën Rinore Evropiane;
c. mundësimin e shpërndarjes së materialeve informuese dhe promovuese në shkolla, qendra rinore dhe hapësira të tjera publike ku të rinjtë qëndrojnë;
d. përfshirjen e BONEVET Prishtinë në evente dhe aktivitete komunale relevante për të rinjtë, me qëllim promovimin e Kartës dhe mundësive që ajo ofron;
e. ofrimin e mbështetjes logjistike, kur është e mundur, për organizimin e aktiviteteve informuese dhe promovuese në nivel lokal;

European Youth Card
Karta Rinore Evropiane - Kosova

Neni 5
Zbatimi i memorandumit

a. ky memorandum nuk detyron ligjërisht asnjërën palë, mirëpo shërben si marrëveshje e vullnetit të mirë mes dy palëve;
b. kjo marrëveshje nuk krijon detyrime financiare për palët — çdo aktivitet që kërkon angazhime financiare do të rregullohet përmes marrëveshjeve ose projekteve të veçanta ndërmjet palëve;
c. palët mund të përdorin logot dhe elementet e identitetit vizual të njëra-tjetrës vetëm për qëllime të promovimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe në përputhje me rregullat e komunikimit të secilës palë;
d. me qëllim të ruajtjes së të dhënave personale, palët pajtohen që të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.06/L-082, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i publikuar në Gazetën Zyrtare më dt. 20.02.2019.

Neni 6
Vlefshmëria, ndryshimet dhe plotësimet

a. ky memorandum hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët dhe mbetet në fuqi për një periudhë prej 2 (dy) vitesh, me mundësi rinovimi me marrëveshje të ndërsjellë;
b. ndryshimet dhe plotësimet e këtij memorandumi bëhen vetëm me pajtim të të dyja palëve, me shkrim;
c. secila palë ka të drejtë të ndërpresë këtë Memorandum duke njoftuar palën tjetër me shkrim të paktën 30 (tridhjetë) ditë paraprakisht.

Neni 7
Dispozitat përfundimtare

a. ky Memorandum është hartuar në katër kopje identike, nga të cilat secila palë do të mbajë nga dy kopje origjinale;
b. çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i këtij Memorandumi do të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes dialogut dhe konsultimeve ndërmjet palëve.

Shtime, 17/09/206

Komuna e Shtimes
Qemajl Aliu
Kryetar i Komunës
Nënshkrimi:

REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA · KOMUNA E SHTIMES · OPSTINA SHTIMLJE · SHTIME · STIMLJE

Fondacioni BONEVET Prishtinë
Artina Bojku
Koordinatore e Projektit
Nënshkrimi:

FONDACIONI BONEVET
Nr. 801810197